

KËRKIME GJUHËSORE

Ema KRISTO

FJALËT BRIZANTE (CATCHWORDS) NË SHTYPIN SHQIPTAR TË VITEVE TË FUNDIT DHE SFONDI I TYRE SOCIOLINGUISTIK DHE SOCIOKULTUROR

Nevoja në politikë për të shprehur konflikte interesash me anë të mjeteve publicistike në fushën e mediave çon shpesh në përdorimin e fjalëve brizante, tipike për gjuhën e politikës. Këto fjalë përdoren nga grupe të ndryshme shoqërore në diskursin publik, në konfliktin e mendimeve si dhe në luftën për fuqi politike me përmbajtje, interesa dhe qëllime të ndryshme. Fjalët brizante provokojnë reagime të ndryshme emocionale dhe mbartin një konotacion pozitiv apo negativ, në varësi të përvojës së personave në komunikim.

Veç rolit të rëndësishëm që ato luajnë në propagandën politike, fjalët brizante përdoren në mënyrë apelative në diskurse mbi tema aktuale, duke shkaktuar tek marrësit (dëgjuesit) një qëndrim afektiv. Kjo veti u jep atyre një dinamikë të veçantë: Këto fjalë, jo vetëm që arrijnë të shkaktojnë tek dëgjuesit entuziazëm, por në bazë të emocionalitetit të tyre ato të nxisin të veprosht.

Qëllimi kryesor i këtij artikulli është karakterizimi i fjalëve brizante, nxjerrja në pah e veçorive themelore të tyre si dhe mënyra e përdorimit të tyre në diskursin politik shqiptar pas viteve 90.

Krahas kësaj në artikull do të paraqiten edhe çështje metodologjike në lidhje me hartimin e një korpusi fjalësh brizante të cituara nga gazetatat kryesore të vendit të konkretizuara me shembuj.

Në Evropë kërkimi shkencor mbi fjalët brizante deri tashmë është i pranishëm pothuajse në mënyrë ekskluzive në Gjermani. Me përjashtim të disa studimeve të veçanta mbi fjalët brizante në gjuhën frënge, italiane ose angleze zanafilla teorike në nivel ndërkombëtar në këtë fushë mungojnë krejtësisht. Kjo mund të jetë e lidhur me faktin, që në shumë gjuhë nuk ka një përkim adekuat për emërtimin “fjalë brizante”. Kjo vlen edhe për gjuhën shqipe. Në fjalorët shqip dygjuhësh dhe shpjegues *fjalë brizante* përkthehet më shpesh me *parullë* dhe *slogan*. *Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe* e përkufizon *parullë* si “një apel/thirrje të shkurtër me përmbajtje politike në tubime, demonstrata etj. një ide ose parim, i cili shpreh në një kohë të caktuar qëllimin kryesor të veprimtarisë sociale dhe politike” dhe *slogan* si “një shprehje të shkurtër, e cila përsëritet shpesh për të propaganduar diçka; parullë boshe ose mashtuese”.¹ Në *Fjalorin Terminologjik të Gjuhësisë Shqipe* ‘*fjalë brizante*’ përkthehet me *fjalë fluturake* dhe sqarohet si më poshtë vijon: “Shprehje ose parullë/thënie e njohur dhe e përdorur shpesh, e cila përmban një mendim ose një vlerësim të përgjithshëm.”²

Meqenëse në hapësirën gjuhësore shqipe deri tani nuk ka studime kërkimore dhe botime për teorinë e fjalëve brizante, atëherë ky artikull mbështetet

¹ Fjalori i Shqipes së Sotme (FSHS), 2002, f. 936 dhe f. 1193.

² Fjalori i termave të gjuhësisë, 1975, f. 528.

në rezultatet e kërkimit shkencor gjerman dhe merr shkas nga tradita prej disa dekadash të këtij kërkimi në rajonin gjermanishtfolës. Në këtë studim, i cili merret me fjalët brizante shqipe të periudhës 1990-2001 synohet të jepet një kontribut në kërkimin shkencor për hapësirën shqipfolëse.

Përdorimi i fjalëve brizante është i lidhur ngushtë me historinë e një vendi. Vetëm në lidhje me një ngjarje historike një fjalë mund të kthehet në fjalë brizante dhe çdo analizë e një fjale të tillë presupozon një ndjekje të saktë të ngjarjeve historike. Prandaj nuk është rastësi, që shumica e autorëve, të cilët kanë shkruar deri tashme mbi fjalët brizante, kanë zgjedhur si sfond historik periudhat e luftërave dhe të tranzicioneve (ndryshimeve rrënjësore politike). Periudha të tilla kohore krijojnë një terren të frytshëm për formime të reja fjalësh brizante.

Në albanologji fjalët brizante si temë e veçantë kërkimore deri më sot nuk janë trajtuar mjaftueshëm. Përveç mungesës së një termi ekuivalent një tjetër arsye për këtë boshllëk kërkimor është gjithashtu edhe diktatura komuniste në pushtet për dekada të tëra, në të cilën fjalët brizante si pjesë përbërëse të sloganeve ishin të pranishme në jetën e përditshme shqiptare, por nuk mund të bëheshin objekt i analizave kritike. Pas përfundimit të diktaturës në morinë e çështjeve të hapura shkencore të gjuhësisë u vendosën prioritete të tjera, kështu që kërkimi shkencor mbi fjalët brizante është lënë pas dore deri më sot.

Procesi i transformimeve politike në Shqipëri që nga viti 1990 ka lënë gjurmë edhe në formimin gjuhësor. Disa artikuj në fushën e leksikologjisë dhe leksikografisë janë marrë në të vërtetë me këtë temë, por studime të hollësishme për fjalorin politik dhe punime për kërkimin shkencor të fjalëve brizante nuk janë ende të pranishme. Deri më sot mund të gjenden disa pikënisje dhe udhëzime jospesifike. Në këtë mënyrë JANI THOMAI në veprën e tij bazë *Leksikologjia e gjuhës shqipe* (1989) hulumton mundësitë e zgjerimit të fjalorit politik në nivelin morfologjik (formal-gramatikor). Tek BALLHYSA/JASHARI³ gjenden aty-këtu përkufizime të dukurive gjuhësore, të cilat janë të ngjashme me fjalët brizante.

Fjalori enciklopedik i politikës i botuar në vitin 2005 është fjalori i vetëm politik në gjuhën shqipe. Ai informon në 1066 fjalë mbi rrymat më të rëndësishme politike, botëkuptimet dhe formacionet e partive politike dhe përmban përkufizime dhe shpjegime të termave qendrore kryesisht të politikës ndërkombëtare. Vetëm disa artikuj pasqyrojnë lidhjen me zhvillimin politik në Shqipëri. Fjalori përmban më shumë vlerësime në një mënyrë të shprehuri shumë emocionale. Për këto arsye, kjo enciklopedi të ndihmon për hulumtimin dhe studimin e fjalëve brizante në gjuhën shqipe në mënyrë të kushtëzuar.

MIÇO SAMARA ka botuar midis viteve 1970 dhe 2000 disa artikuj për leksikun politik të gjuhës shqipe;⁴ Në vitin 2008 u botua në Tiranë studimi i tij *Rreth leksikut politik e shoqëror në gjuhën shqipe*. Libri trajton në radhë të parë zhvillimin historik të leksikut politik në Shqipëri dhe përhapjen e tij si edhe

³ Ballhysa/Jashari, 2007, f. 36-38.

⁴ Shiko Samara 1970, 1985, 1987, 2000.

FJALËT BRIZANTE NË SHTYPIN SHQIPTAR TË VITEVE TË FUNDIT DHE SFONDI I TYRE SOCIOLOGJIK DHE SOCIOKULTUROR

çështjet e normës gjuhësore në fushën e debateve politike, i rëndësishëm për tematikën e punimit shkencor të pranishëm është në librin e Samarës Kapitulli 3, në të cilin ai trajton koncepte dhe parulla politike nga pikëpamja linguistike/gjuhësore. Ky kapitull ofron një përshkrim të plotë e të gjithanshëm të tipeve/llojeve dhe modeleve të fjalëformimeve për foljet, mbiemrat, ndajfoljet dhe emrat e fjalorit politik si edhe motivet kryesore dhe mundësitë për një zgjerim të këtij fjalori. Marrja pjesë e fjalëformimit në zgjerimin e fjalorit të gjuhës shqipe duke përdorur të gjitha metodat e zakonshme të fjalëformimit është e konsiderueshme.

Artikulli i LINDA MËNIKUT *Besonderheiten des Konfliktdiskurses in der albanischen Tagespresse*⁵ (Veçoritë e diskutimit konfliktual në shtypin ditor shqiptar) paraqet një studim empirik mbi rolin shoqëror dhe social të mediave në Shqipëri. Mëniku e hap studimin e saj me një vështrim në stilin e diskutimit konfliktual në shtypin ditor shqiptar që prej vitit 1989. Ajo kontekstualizon një korpus të gjithanshëm të citateve nga fjalët armiqësore, luftarake dhe sharëse/tallëse të përhapura gjerësisht në këto media dhe problematizon në këtë mënyrë çështjen për rolin e mediave në procesin e transformimeve politike të Shqipërisë dhe hulumton, nëse shtypi në Shqipëri është vetëm një pasqyrë e situatës politike ose për më tepër një instrument i manipulimit dhe drejtimit të opinionit publik. Disa nga përfundimet në artikullin e saj janë të rëndësishme për këtë punim shkencor.

Duke e përmbledhur konstatohet, që kërkimi shkencor i fjalëve brizante në gjuhën shqipe është ende në fillimet e tij. Për t'u bërë objekt i kërkimit shkencor të veçantë fenomeni *fjalë brizante* duhet të njihet e përshkruhet si i tillë. Bazat dhe impulset teorike për punimet shkencore të mëtejshme kërkimi shkencor i gjuhës shqipe mund t'i marrë nga vendet gjermanishtfolëse, ku kërkimi shkencor i fjalëve brizante ka një traditë mbi qindvjeçare.

Kërkimi shkencor i fjalëve brizante në gjuhën gjermane. Kërkimi shkencor i fjalëve brizante në gjuhën gjermane ka një spektër të gjerë të mënyrave të ndryshme të vështrimit dhe të trajtimit, për të cilin krahas shkencëtarëve të letërsisë dhe gjuhësisë kanë kontribuar gjithashtu edhe historianë dhe politologë. Kërkimi shkencor përfshin punime shkencore për teorinë e fjalëve brizante dhe analiza të tyre nga epoka të ndryshme të historisë gjermane. Vështrimi i shkurtër i përgjithshëm i mëposhtëm kufizohet tek autorët apo veprat, të cilët shënojnë hapa të rëndësishme në rrugën e zhvillimit të kërkimit shkencor mbi fjalët brizante.

Fillimin e një diskutimi teorik mbi fjalët brizante si fenomen linguistik e shënon Otto LADENDORF *Historisches Schlagwörterbuch (Fjalori historik i fjalëve brizante)* të vitit 1906, i cili u bë vepra klasike themelore e leksikografisë së fjalëve brizante në gjuhën gjermane. Ladendorf ishte i pari që u përpoq për një

⁵ Mëniku, 2003, f. 243-252. Në: Busch, Dominik et al., Medientransformationsprozesse, Gesellschaftlicher Wandel und Demokratisierung in Südosteuropa. Frankfurt am Main: Peter Lang.

përkufizim të nocionit të fjalëve brizante, duke cilësuar dhe quajtur si fjalë brizante „ato fjalë dhe shprehje të tilla, për të cilat është tipike jo vetëm një *formë koncize* por edhe një *vlerë emocionale në rritje*, për aq sa ato konkretisht [...] theksojnë shprehimisht një këndvështrim ose pikëpamje të caktuar pro ose kundra një synimi, një institucioni publik, një ngjarje [...]“.⁶ Si një tjetër tipar ai quan „kufizimin e përdorimit në drejtimin kohor, hapësinor por edhe social“.⁷ Megjithëse përshkrimi i Ladendorf është i vagët ai përfshin elemente thelbësore të fenomenit.⁸

Friedrich LEPP paraqiti në vitin 1908 studimin e tij *Schlagwörter des Reformationszeitalters (Fjalët brizante të periudhës së reformacionit)*. Me këtë studim Lepp është personi i parë, i cili hulumton dhe i rendit fjalët brizante të një epoke nën këndvështrime tematike dhe i kupton ato si shprehje karakteristike të natyrës së një epoke.⁹

Historiani Wilhelm BAUER i dha kërkimit shkencor të fjalëve brizante frymëzime dhe nxitje të vlefshme me artikullin e tij *Das Schlagwort als sozialpsychische und geistesgeschichtliche Erscheinung (Fjalët brizante si dukuri sociale-shpirtërore dhe shpirtërore-historike)* (1920). Nga historia e krijimit të një parulle, e cila e ka pikënisjen e saj „në përplasjen e mendimeve“¹⁰, Bauer nxjerr veçoritë dalluese të fjalëve brizante: Heqja e kuptimit fillestar të fjalës, theksimi i ndjenjave, simbol i një drejtimi të caktuar mendimesh, me të cilin ajo shfaqet dhe zhduket.¹¹ Një fjalë kthehet në brizante kur ajo hyn nga faza e saj e parë konkrete-logjike në një fazë të dytë, në të cilën ajo është zgjeruar konceptualisht dhe është e lidhur me emocione të forta.¹² Bazën për këtë zgjerim kuptimi Bauer e shikon në vlerën emocionale të gjuhës, e cila njëkohësisht është kusht paraprak për mundësinë e efektshmërisë së fjalëve brizante.¹³ Sipas Bauer fjalët brizante shfaqen kudo, ku ka mosmarrëveshje dhe diskutime, sidomos në politikë.¹⁴

Fjala brizante si term lingistik. Një problem themelor të kërkimit shkencor të fjalëve brizante e paraqet përkufizimi i saktë i nocionit shkencor të tyre. Siç paraqitet më lart, në gjuhësinë shqipe nuk gjenden pikënisje për një përkufizim ose përshkrim të këtij fenomeni gjuhësor. Por meqenëse për një hulumtim të fjalëve brizante është kusht i domosdoshëm një përkufizim nocioni të objektit që duhet të hulumtohet, atëhere jemi munduar të japim një përkufizim të fjalëve brizante, përkufizim i cili për qëllimin kërkimor vendoset në themel të këtij punimi shkencor.

⁶ Ladendorf, 1906, f. VII.

⁷ Po këtu f. IXf.

⁸ Krahaso Schottmann, 1997, f. 20.

⁹ Krahaso Diekmannshenke, 1994, f. 9f.

¹⁰ Bauer, 1920, f. 208.

¹¹ Krahaso po këtu, f. 229.

¹² Krahaso po këtu, f. 212.

¹³ Krahaso Schottmann, 1997, f. 21f.

¹⁴ Krahaso Schottmann, 1997, f. 22.

FJALËT BRIZANTE NË SHTYPIN SHQIPTAR TË VITEVE TË FUNDIT DHE SFONDI I TYRE SOCIOLOGJIK DHE SOCIOKULTUROR

Karakteristikat e fjalëve brizante. Një përmbledhje e cilësive dhe tipareve, të cilat autorë të ndryshëm i quajnë të rëndësishme dhe thelbësore për fjalët brizante, tregon morinë e karakteristikave të tyre:

Fjalët brizante janë:

- pjesë përbërëse e gjuhës publike ose e gjuhës politike, ideologjike
- karakterizohen nga një shpeshësi e përkohshme e përdorimit
- janë mjete të fjalimit (agjitativ) (mjete luftarake, ndikim, argument)
- karakterizohen nga një mbartje e madhe emocionale
- janë shprehje e një pikëpamjeje partiake / karakter vlerësues
- kanë karakter provokues / lutës / apelativ
- dallohen për efekt solidarizues
- kanë kuptim konciz/të përpiktë¹⁵

Nisur nga karakteristikat e mësipërme përcaktimi apo definicioni mbi fjalët brizante përfshin rrafshin morfologjik-sintaksor, por kryesisht atë semantik dhe pragmatik.

1. Në nivelin semantik: Me *fjalë brizante* ne kuptojmë ato fjalë apo shprehje, në të cilat përqendrohet një program ose të cilat emërtojnë dhe identifikojnë një vizion.

2. Në nivelin pragmatik: Fjalët brizante fitojnë domethënie dhe aktualitet të veçantë në një shoqëri ose grup të caktuar

3. Në nivelin morfologjik: Fjalët brizante janë leksema ose sintagma me statusin e leksemave me shumë fjalë.¹⁶

Karakteristikat e tjera si shpeshësia e përdorimit, mbartja e emocioneve (pohuese ose polemizuese), paqartësia dhe shumë variante janë cilësi dytësore të fjalëve brizante, të cilat rrjedhin nga karakteristikat kryesore.¹⁷

Pionierët e kërkimit shkencor të fjalëve brizante e shohin terrenin e lindjes së tyre në konfrontimin midis palëve/partive.¹⁸ Nga kjo polemikë mendimesh të diskutuarit rezulton si tipar dallues semantik i fjalës brizante, i cili shprehet në vlerësime dhe vizione të ndryshme.

Nga ana pragmatike fjalët brizante karakterizohen nga fakti që ato përdoren në kuadër të diskutimeve për tema me domethënie dhe kuptim aktual për një shoqëri të caktuar, qoftë kjo në konsensusin apo në polemikën e mendimeve. Përcaktimi, që një fjalë brizante duhet të jetë aktuale, nënkupton njëkohësisht edhe jetëgjatësinë e saj të shkurtër.

Aktualiteti dhe rëndësia e një teme për një shoqëri ose grupe e pajisin fjalën brizante me emocionalitet dhe njëanshmëri. Këto karakteristika vlejnë në kërkimin shkencor në përgjithësi si cilësi dhe tipare të domosdoshme të saj. „Nëse

¹⁵ Krahaso Kaempfert, 1990a, f. 198f.

¹⁶ Kaempfert, 1990b, f. 1200.

¹⁷ Krahaso po këtu.

¹⁸ Krahaso Lepp 1908, f. 8f. ose Bauer, 1920, f. 228.

nuk ekziston më komponenti emocional, atëhere fjala brizante pushon të jetë e tillë: Ajo shuhet.¹⁹

Kusht për lindjen dhe ngulitjen e një fjale brizante janë prania e një shoqërie të caktuar komunikimi, tema rreth fjalës dhe qëndrimet që mbahen rreth kësaj teme.

Në procesin e komunikimit, gjatë të cilit një fjalë kthehet në një fjalë brizante, dërguesi transmeton një përmbajtje të caktuar, me qëllim që të veprojë tek marrësi. Dërguesi e përqendron këtë përmbajtje tek një fjalë e caktuar, e përdor atë në mënyrë të përsëritur në kontekste të ngarkuara emocionalisht me qëllim që të bindë marrësin.

Ndryshimet midis fjalëve brizante dhe koncepteve të tjera të ngjashme me to. Fjalët brizante ndryshojnë nga njësitë e tjera leksikore nëpërmjet një strukture të caktuar semantike dhe një funksioni të caktuar në komunikim. Fjalët brizante dallojnë nga fjalët e modës, fjalët sharëse, fjalës çelës, termat etj.

Kufiri midis *fjalëve modë* dhe *fjalëve brizante* nuk është shumë i prerë, pasi të dyja kategoritë kanë shumë tipare të përbashkëta. Të dyja janë me interes shoqëror, dallohen për një tipar të veçantë të përkohshëm në përdorimin e përditshëm dhe përmbajnë një komponent funksional.

Por ndërsa fjalët brizante ushtrojnë një ndikim në drejtimin e duhur të marrësit, fjalët e modës e drejtojnë vëmendjen ndaj përdoruesit të tyre. Në përdorimin e fjalëve të modës qëndron në plan të parë ndjenja kolektive. Ato forcojnë ndjenjën e grupit dhe i përkasin një norme gjuhësore brenda grupit. Fakti që ato nuk përmbajnë komponente emocionale dhe përmbajtje programatike, i dallon ato qartë nga fjalët brizante.

Edhe ndryshimi midis *fjalëve sharëse* dhe *fjalëve brizante* qëndron në sferën semantike, pasi tek fjalët sharëse mungon komponenti programatik.

Sllloganet ndahen qartë nga fjalët brizante pasi vetëm leksemat, sintagma mund të vlejnë si fjalë brizante por jo fjalitë eliptike.

Parrullat kanë vërtet karakter të ngjashëm me fjalët brizante, por ato shfaqen në fjalë të plota ose eliptike. Parrullat mishërojnë një ideologji të caktuar.

Termi dhe fjalët brizante kanë tipare të përbashkëta semantike, pasi edhe termi përfaqëson një simbol për një fakt të caktuar. Megjithatë ato ndryshojnë në tiparet pragmatike. Tek fjalët brizante dominon funksioni apelativ, termi ka një funksion paraqitës. Termi i përket gjuhës së specialitetit dhe nuk karakterizohet nga konotacionet emocionale. Por kjo nuk përjashton faktin që një fjalë e caktuar të funksionojë njëkohësisht si term por edhe si fjalë brizante.

Çështje metodologjike. Si material për kërkimin e fjalëve brizante të gjuhës së politikës në Shqipëri u shfrytëzua një korpus tekstesh të marra nga 4 gazeta shqiptare të viteve 1990-2001. Gazetat e kësaj kohe ndahen në tre kategori: Organe të partive politike, gazeta të pavarura ekonomikisht me një drejtim të

¹⁹ Bauer, 1920, f. 231.

FJALËT BRIZANTE NË SHTYPIN SHQIPTAR TË VITEVE TË FUNDIT DHE SFONDI I TYRE SOCIOLOGJIK DHE SOCIOKULTUROR

caktuar politik dhe gazeta të pavarura ekonomikisht dhe politikisht.²⁰ Si organe politike u zgjodhën për këtë korpus gazetat “Zëri i popullit” dhe “Rilindja Demokratike”. Nga dy grupet e tjera u zgjodhën “Koha jonë” dhe “Gazeta 55”.

Hartimi i korpusit. Bazuar në definicionin e fjalëve brizante si dhe në karakteristikat e tyre u ndërtua një korpus prej 70 fjalësh. Të tilla janë ndërmjet të tjerash: demokraci, liri, lëvizja e dhjetorit, shengeni ballkanik, europa, muri shengen, westomania, kioskomania etj.

Për kërkimin e fjalëve brizante në organet e shtypit një tregues mjaft i rëndësishëm ishte lloji i tekstit. Kryesisht tekstet e faqeve të para, reklammat e zgjedhjeve, programet e ndryshme politike por edhe letrat drejtuar redaksisë përbënin një burim të rëndësishëm për gjetjen e fjalëve të tilla. Edhe tregues të tillë si: shkrimi me shkronja kapitale ose kursiv, theksimi me anë të thonjzave etj. përbënin gjithashtu një ndihmesë për identifikimin e fjalëve brizante.

Shembuj:

Pranvera e tretë e **demokracisë** në Shqipëri

Sot filloi në Shqipëri pranvera e tretë e demokracisë ndaj dhe unë sot nga zemra dua t’i uroj demokracisë shqiptare pranverë të përhershme dhe ju, bashkëkombasve të mi mbarësi, suksese gjithnjë e më të mëdha në rrugën që kemi zgjedhur dy vjet më parë, më 22 mars, rrugën e demokracisë.

(Rilindja Demokratike, 23.03.1992, f. 1)

DEMOKRACIA – IDEAL I NJERIUT TË MIRË

(Rilindja Demokratike, 09.02.1994, f. 3)

E ardhmja e Shqipërisë është **Europa**

(Rilindja Demokratike, 22.11.1992, f. 1)

Lëvizja e dhjetorit [...] është një lëvizje që u frymëzua nga shpirti i lirisë dhe i ndryshimit. Dhjetori nuk kishte ideale. [...] Lëvizja e dhjetorit ishte thjesht një ëndërr [...] e mijëra e mijërave njerëzve që ëndërronin të ishin të lirë [...]. (Zëri i Popullit, 10.12.1997, f. 3)

Demokracinë e kemi të shenjtë si **lirinë**

[...] Neve na duhet demokracia e vërtetë, jo “demokracia” e disa fundërrinave. Kush nuk do popullin e vendin e vet, nuk ka si të mendojë për të mirën e tyre. Ata nuk përfillin logjikën e ligjeve tona aq popullore. Veprime të tilla janë shkelje flagrante e demokracisë. [...] (Zëri i Popullit, 06.07.1990, f. 2)

Drejt **Evropës**, por me kulturë e maturi

[...]drejt Evropës ne duhet të shkojmë, por duhet të shkojmë me kulturën tonë, me traditën tonë, me origjinalitetin tonë, prandaj edhe duhet të jemi të matur. [...] (Zëri i Popullit, 14.12.1990, f. 1-2)

Përfundime. Periudha kohore e viteve 1990-2001 paraqitet si një periudhë mjaft e frytshme për kërkimin dhe analizën e fjalëve brizante në

²⁰ Londo 2004, f. 151.

Shqipëri. Kjo tregon se periudha transformacionesh në shoqëri dhe vende të caktuara janë të përshtatshme për analiza fjalësh brizante.

Fjalët brizante pasqyrojnë diskursat qendrore të zhvillimeve politike e historike të një vendi si dhe përbëjnë elementët bazë emocionalë të këtyre diskurseve. Ato janë pjesë përbërëse e semantikës politike dhe gjithmonë të pranishme në diskursat publike mbi një temë aktuale.

BIBLIOGRAFI

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor i Shqipes së sotme*. Tiranë, 2002
- A. BALLHYSA, /A. JASHARI, *Formim gjuhësor*. Elbasan, 2007.
- CH. SCHOTTMAN, Politische Schlagwörter in Deutschland zwischen 1929 und 1934. Stuttgart, 1997.
- F. LEPP, Schlagwörter des Reformationszeitalters. Leipzig, 1908.
- Fjalor i termave të gjuhësisë, Tiranë, 1975.
- H-J. Diekmannshenke, Die Schlagwörter der Radikalen der Reformationszeit (1520-1536). Spuren utopischen Bewusstseins, Frankfurt/Main 1993.
- I. Londo, Mediaownership and its impact on media pluralism and independence. Media Institute Tirana: 2004.
- Në: <http://www.institutemedia.org/documenta/ownership2004.pdf>
- J. THOMAI, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2005.
- L. MËNIKU, *Besonderheiten des Konfliktdiskurses in der albanischen Tagespresse*. Në: Busch Dominic et al.: Medientransformationsprozesse, gesellschaftlicher Wandel und Demokratisierung in Südosteuropa. Frankfurt am Main, 2003, f. 243-251.
- M. Kaempfert, Die Schlagwörter. Noch einmal zur Wortgeschichte und zum lexikologischen Begriff. Në: Muttersprache 100, 1990a, f.192-203.
- M. Kaempfert, *Das Schlagwörterbuch*. Në: Hausmann, Franz Josef u.a.: Wörterbücher. Ein Internationales Handbuch zur Lexikographie. Bd. 2. Berlin, New York: de Gruyter, 1990b f. 1199-1206.
- M. SAMARA, *Zhvillimi i leksikut politiko-shoqëror* Në: Studime filologjike 1, Tiranë, 1985.
- M. SAMARA, Çështje të normës në fushën e leksikut politiko-shoqëror. Në: Gjuha Jonë/1, Tiranë, 1987.
- M. SAMARA, *Mbi tiparet e leksikut politiko-shoqëror*. Në: Studime filologjike 1, Tiranë, 1991.
- M. SAMARA, Rreth leksikut politik e shoqëror në gjuhën shqipe. Tiranë, 2008
- O. Ladendorf, Historisches Schlagwörterbuch. Ein Versuch. Straßburg, 1906.
- R. Freitag, *Zum Wesen des Schlagwortes und verwandter sprachlicher Erscheinungen*. Në: Wissenschaftliche Zeitschrift der Karl-Marx-Universität Leipzig, Gesellschafts- und sprachwissenschaftliche Reihe 23. 1994, f. 119-139.
- W. Bauer, Das Schlagwort als sozialpsychische und geistesgeschichtliche Erscheinung. Në: Historische Zeitschrift 122, München, 1920, f.189-240.